



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BULQIZE
NJESIA E PROKURIMIT**

Data: 22 .02.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburant (Nafte), Bashkia Bulqize

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134000-7
(Karburant diezel)**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 16 753 333 (Gjashtembedhjete milion e gjashtëqind e
gjashtëdhjete e gjashte mije e gjashtëqind e gjashtëdhjete e gjashte), pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Bulqize ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, neneve 26 dhe 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, të LPP, *ky kriter kërkohej sepse vertetohet se operatorët ekonomik kanë kapacitetet e duhura ligjore për kryerjen e furnizimeve të mallrave*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të leshuara nga administrata tatimore përgjate tre viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se vlera e fondit limit që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar .

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nen 29. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021,2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2023** prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Kriteri për piken 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Shënim: Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë fizikisht pranë Bashkisë Bulqize dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës furnizime të mëparshme, të ngjashme me objektin e këtij prokurimi me vlerë totale jo më pak se 40% e fondit limit që prokurohet:

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit për të cilin konkuron, që është **brenda vlerës kufi të përcaktuar** në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 pikë furnizimi të tregëtimit të karburantit në Njesinë Administrative, Bashkia Bulqize e pasqyruar kjo tek të dhënat në QKR dhe e pasqyruar me Niptet (Adresat) Sekondare, shoqeruar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil kontrate qeraje ose akt pronësie

Argumentim: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektivit të prokurimit.

Realizimi i kësaj kontrate ka për qëllim furnizimin me karburant të Bashkisë Bulqize ku përfshihen mjetet e Policisë Bashkiake, IMT, Njësive Administrative, Drejtorise se shërbimeve, etj, ndaj është menduar që operatori ekonomik të ketë të paktën 1 pikë furnizimi brenda territorit të Bashkisë Bulqize (pika të furnizimit me karburant), për të cilat duhet të disponojë edhe dokumentacionin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.3.3 Autorizim të ushtrimit të aktivitetit (Tregtim me pakicë karburantesh) e lëshuar nga Njësia Vendore dhe që plotëson kushtet e legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë, Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose. Nr. 970, datë 2.12.2015 Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj ndryshuar me VENDIM Nr. 344, datë 19.4.2017.

2.3.4 Fletë analiza të lëshuar nga ISHTI te vlefshme.

Argumentimi: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40,pika 6, germa c, të me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë, , kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

c)dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Si dhe VKM Nr.147, datë 21.3.2007 për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel

Me ane te ketij kriteri Autoriteti kontraktor verteton qe malli objekt prokurimi eshte sipas specifikimeve teknike te kerkuara.

2.3.5 Vërtetim lëshuar nga nje institucion/ apo organ i akredituar, që stacioni i shitjes së karburantit respekton normat teknike të aktivitetit shitje karburanti.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë te dëshmojnë , Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale,

kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose si dhe VKM Nr. 491, datë 19.7.2017 për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës,të gazit dhe nënprodukteve të tyre.

2.3.6 Stacioni i shitjes me pakicë të karburantit të jetë i siguruar për përgjegjësitë ligjore ndaj palëve të treta.

Argumentimi: Kjo kerkese Bazohet ne VKM “Përdisa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar me VKM nr.1047, datë 16.7.2008.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, deri në përfundimin

e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor për këto të paraqitet deklaratë që garanton dhe është i disponueshëm për furnizimin 24/24 për 7 ditë javës..

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kjo pike e vendosur nga AK i sherben Autoritetit Kontraktor qe operatori ekonomik te jete i disponueshem ne cdo dite/ore per furnizimin me karburant te mjeteve.

2.3.8Referuar VKM-se Nr 561 date 29.07.2016“Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ”ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 561, datë 29.07.2016, “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem“. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të vetdeklarimit se ofron një webpage për menaxhimin e karburanteve, në mënyrë që të të ofrojë shërbimin e ngarkimit/transferimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit kontraktor me karte elektronike.

Sasia e litrave te pritshme qe kerkohej 106 498 (njeqind e gjashte mije e katerqind e nentedhete e tete) eshte llogaritur referuar cmimeve te karburanteve nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Departamenti Teknik, Drejtoria e Vleresimit Qender, shkarkuar nga APP, e perditesuar.Cmimi nga \$ ne leke eshte nxjer sipas kursit te kembimit valutor te Bankes se Shqiperise

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, janë hartuar në

përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndës djegëse, diesel” dhe standarteve shtetërore në fuq.Për këtë objekt prokurimi autoriteti kontraktor ka përdorur specifikimet teknike duke ju referuar standardeve kombëtare, të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve. Kërkesat e mësipërme janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke shërbyer për autoritetin kontraktor për njohjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

NJESIA E PROKURIMIT